



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 587, Datë 28.01.2019

“Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Marrja e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike ndaj Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë;

Baza Ligjore: Neni 4 , neni 24, shkronja (d), neni 44 dhe neni 69 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003)

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE :

1. Nga media e shkruar dhe ajo vizive, në datë 25 janar 2019 jemi informuar lidhur me një Vendim të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, Vendimi nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik” sipas të cilit, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysheme për këtë shërbim.
2. Misioni i Urdhrit të Stomatologeve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit të stomatologut dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga keq ushtrimi i këtij profesioni.
3. Urdhri i Stomatologut funksionon dhe rregullohet nga Ligji nr. 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.
4. Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë është ent publik, jo buxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesionistëve, stomatologë dhe ndihmës stomatologë, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut.

5. Sipas vendimit nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik” sipas të cilit, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysheme për një kategori të caktuar shërbimesh dentare për: Terapinë, Ortopedinë, Kirurgjinë dhe Ortodoncinë.
6. Në bazë të nenit 4 të Ligjit 9121/2003 janë të ndaluara të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg. Vendimi i mësipërm i Urdhrit të Stomatologut, mund të ketë elementë të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 4 të Ligjit 9121/2003;
7. Si përfundim, bazuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësojmë se jemi përpara një rasti urgjence, pasi Vendimi i Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik”, sjell një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) , nenin 44 dhe nenin 69 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike ndaj Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë si vijon:
 - a) Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të Vendimit të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, Vendimit nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik”, pasi bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;
 - b) Depozitimin e të gjithë praktikës së ndjekur deri në marrjen e këtij vendimi, për të kryer vlerësimin ligjor të tij, bazuar në nenin 4 dhe 69 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;
2. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore;
3. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b) të Ligjit Nr. 9121/2003;
4. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi , bazuar në nenin 78 “Sanksione Individuale”, parashikohet vendosja e gjobave individuale në masën deri 5 milionë lekë për individët që me dashje ose nga pakujdesia kryejnë ose bashkëpunojnë në veprimet e sanksionuara në nenin 73 pika 1 dhe 74 pika 1 e Ligjit 9121/2003.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS